




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.04/18

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi-Kryetar, zBlerim Dina- Referues, z.Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: “NTP Prima Engineering sh.p.k. – Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Konkurs projektimi për hartimin e projektit me nevoja të veçanta Sindrom Dowën dhe Autizem” me nr.prok.616/17/3336/423, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, më datë: 12.02.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET siebazuar ankesa e operatorit ekonomik: “NTP Prima Engineering sh.p.k. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konkurs projektimi për hartimin e projektit me nevoja të veçanta Sindrom Dowën dhe Autizem” me nr.prok.616/17/3336/423, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

II. ANULOHET njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Konkurs projektimi për hartimin e projektit me nevoja të veçanta Sindrom Dowën dhe Autizem” me nr.prok.616/17/3336/423, dhe lënda kthehet në Ri-vlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "NTP Prima Engineering" sh.p.k. – Prishtinë, aprovohet si e bazuar, te njëjtit operator ekonomik ikthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues "NTP Prima Engineering" sh.p.k. – Prishtinë që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për konkursin e projektimit: i shpallur me 19 korrik 2017.

Njoftim për informata shtese (shtyrjen e afatit të dorëzimit): 28 korrik 2017.

Afati i fundit përdorëzimin e dokumentacionit të kandidatit dhe koncept projekteve: 4 shtator 2017, ora 14:00.

Njoftimi për anulim: 14 shtator 2017.

Kërkesa e pare për rishqyrtim: 19 shtator 2017;

Plotësimi i kërkesës se pare për rishqyrtim: 20 shtator 2017.

Vendimi mbi aprovimin e Kërkesës se pare për rishqyrtim: 22 shtator 2017.

Raporti i rivlerësimit (vendimi i dyte për anulim): 2 tetor 2017.

- Kërkesa e dyte për rishqyrtim: 2 tetor 2017.

- Vendimi mbi refuzimin e kërkesës se dyte për rishqyrtim: 4 tetor 2017.

-Vendimi i OSHP-se 368/17 për kthimin ne rivlerësim: 8 nëntor 2017.

-Njoftimi për eliminim: 27 dhjetor 2017.

-Kërkesa e trete për Rishqyrtim: 29.12.2017 - Vendimi mbi refuzimin e kërkesës se trete për rishqyrtim: 3 janar 2018.

Operatori ekonomik ankues: "NTP Prima Engineering" sh.p.k. – Prishtinës palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 04 Janar 2018, me nr.04/18, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit me titull: "Konkurs projektimi për hartimin e projektit me nevoja të veçanta Sindrom Down dhe Autizem" me nr.prok.616/17/3336/423, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim dispozitat ligjore të LPP-së:

- Shkelje e nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
- Shkelje e nenit 10, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
- Shkelje e nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
- Shkelje e nenit 80, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.01.2018, ka autorizuar ekspertenshqyrtuese- profesionale, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtuesteknik në raportin e dt: 19.01.2018, ka konstatuar se: Pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues ku thuhet: AK-ja gjatë Ri-vlerësimit pas shpalljes së vendimit të OSHP-së shihet qartë se ka përsëritur shkelje ligjore të cilat i ka bërë dy herë radhazi kur ka marrë vendim për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, duke e shpallur fillimisht projektin 1140 të dobët, dhe pastaj në nivel të papranueshëm duke e poentuar në të gjitha nënkriteret me zero pikë pa i vlerësuar bazuar në këto nënkritere projektin 1140, edhe pse vetë AK në të dy rastet të njëjtin projekt e vlerëson se është në përputhje për Specifikimet Teknike Të Detyrueshme, përkatësisht me përmbajtjen e projektit aplikues (që në dosjen e tenderit është kriteri minimal dhe bazik teknik i Specifikuar për pranueshmërinë e projekteve aplikuese). AK-ja gjatë procesit të rivlerësimit nuk i ka marrë fare për bazë obligimet që dalin nga vendimi i OSHP-së, ku është konstatuar ligjërisht se projekti 1140 është i kompletuar në aspektin fizik të programit projektues; dhe mbi të gjitha se projekti 1140 ka kualitet hapësinor, është projekti i bazuar në programin e dhënë nga AK-ja dhe ka ofruar qasje ekonomike; pastaj konstatimin se AK-ja në Dosjen e Konkursit të Projektimit nuk ka caktuar prag numerik për nivelin e pranueshmërisë prandaj është i paqëndrueshëm konstatimi se projekti 1140 nuk është në nivelin e pranueshëm, si dhe nuk e ka marrë fare për bazë konstatimin se mangësitë eventuale të projektit ideor 1140 mund të plotësohen në fazën e projektit kryesor. Ekspertja shqyrtuese/teknike sqaron se komisioni pas Ri-vlerësimit të projektit konstaton: “Bazuar në sqarimet paraprake komisioni rekomandon anulimin e konkursit të projektimit për mungesë të projekteve të pranueshme”. Ky konstatim i jurisë profesionale është i pa qëndrueshëm pasi që AK-ja nuk ka caktuar prag të kalueshmërisë. Si i tillë pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues vlerësohet si i qëndrueshëm.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet: “Shpjegimet” e AK-se në bazë të të cilave ne jemi eliminuar sërish nga ky autoritet kontraktues nuk janë të bazuara as në Aneksin 1. Specifikimet Teknike dhe/ose estetike të Detyrueshme të dosjes së Konkursit për projektim dhe në as në Nënkriteret Teknike të vlerësimit të prezantuar në FDT dhe në kuadër të këtyre specifikimeve teknike. “Shpjegimet” apo vërejtjet e jurisë profesionale të dhëna në letrën standarde të eliminimit dhe në raportin e Ri-vlerësimit, nuk janë të mbështetura saktësisht me kërkesat e Specifikimeve Teknike të Dosjes së Konkursit të Projektimit e as me

nënkriteret teknike, për arsye se tek tabela e nënkritereve teknike nuk është dhënë asnjë sqarim bazuar në këto Specifikime Teknike të Detyrueshme për poentimin me Zero pikë të secilit nënkriter. Ekspertja shqyrtuese/teknike sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues sepse projekti 1140 është i kompletuar në aspektin fizik të programit projektues duke plotësuar të dhjetë pikat përmbajtjesore të kërkuara në dosjen e konkursit të projektit. Vërejtjet e cekura nga komisioni vlerësues qëndrojnë që të gjitha, por janë vërejtje më shumë teknike dhe jo përmbajtjesore. P.sh. vërejtja e mbrojtësit, sipas specifikimeve teknike të detyrueshëm prezantimi i mbrojtësit ka qenë detyrim, por forma e tij nuk është përcaktuar, si e tillë vërejtja është teknike sepse mundë të ndryshohet gjatë projektit kryesor por asesi nuk është vërejtje përmbajtjesore e cila do ta diskualifikonte projektin në fjalë. Ose tek vërejtjet e prezantimit të prerjeve se nuk janë të përfunduara ose nuk kanë të paraqitur shtresat. Kujtojmë që kemi të bëjmë me fazën e projektit ideor në të cilën fazë mjafton të prezantohen kotat e lartësisë dhe gjithçka tjetër detajizohet paralel me fazën e strukturës dhe fazave tjera.

Pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues ku thuhet: Neni 80, pika 2 e Ligjit të Prokurimit Publik sqaron saktësisht se “Jurija do të vendos mbi konkursin vetëm në bazë të kritereve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit”. Ekspertja shqyrtuese/teknike sqaron se qëndron pretendimi i Operatorit Ekonomik pasi që vërejtjet e cekura në raportin e Ri-vlerësimit janë vërejtje teknike e jo përmbajtjesore e për më shumë nuk janë të cekura në Specifikat Teknike të Detyrueshme të dosjes së projektimit. Edhe neni 57, pika 57.26 e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, sqaron se: “Juria do të vlerësojë projektet vetëm në bazë të kritereve të shënuara (pikët e peshës të shënuara në Dosjen e Konkursit të Projektimit)”. Ekspertja shqyrtuese/teknike sqaron se juria profesionale ka bërë vlerësimin duke u bazuar më shumë në çështje teknike apo prezantim të projektit, por jo duke u thirrur konkretisht në kriteret apo nënkriteret e paraqitura në dosjen e konkursit të projektimit, mbi të cilat është dashtë të bëhet vlerësimi. P.sh. nuk ka dhënë pikë (ku vlerësimi ka mundë të jetë 1 deri në 100 pikë) tek Kriteri Estetik dhe Ekologjik apo tek Nënkriteri Respektimi dhe Përmbushja e Detyrës Projektuese dhe Programit Hapsinor. Nisur nga fakti që projekti 1140 ka qenë i kompletuar në aspektin përmbajtësor atëherë për çdo kriter dhe nënkriter ka pas material për vlerësim, ndërkohë që vlerësimi me 0 pikë është i pakuptim. Ndërsa, neni 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, pika 41.3 (Parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP-së), i po këtij Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik sqaron po ashtu se: “Tenderët duhet të jenë të pranueshëm dhe duhet të përmbushin kërkesat minimale të kualifikimit (nëse janë përcaktuar). Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara. Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kritereve të specifikuara të dhënies së kontratës. Vetëm kërkesat dhe kriteret e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosjen e tenderit mund të përdoren si bazë për vlerësim”. Ekspertja shqyrtuese/teknike sqaron se qëndron pretendimi i Operatorit Ekonomik pasi që projekti 1140 ka përmbushur

kërkesat minimale të kualifikimit të cilat janë specifikuar në Dosjen e Konkursit të Projektimit-që janë: Përmbajtja e Projektit aplikues. Poashtu neni 41, pika 41.11 e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik e definon edhe më qartë se: “Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit”. Ekspertja shqyrtuese/teknike sqaron se vërejtjet e bëra nga juria profesionale nuk janë të bazuara në kriteret apo nënkriteret teknike e as në Specifikimet Teknike të Detyrueshme të dosjes së konkursit të projektimit. Si i tillë pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues është i qëndrueshëm. Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e “Konkurs projektimi për hartimin projektit me nevoja të veçanta Sindromin Down dhe Autizëm”, me nr. të prokurimit: 616 17 3336 423, i propozon panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa autoriteti kontraktues të anuloj vendimin për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, të dt. 27 dhjetor 2017, dhe lëndën ta Ri-kthej në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues –Komuna e Prishtinës me datë: 29.01.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, senuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues teknik.

Operatori ekonomik ankues: “NTP Prima Engineering” sh.p.k. – Prishtinë me datë: 29.01.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, sepajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues teknik

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 12.02.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti i OSHP-së dhe eksperti teknik, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë fjala ju dha përfaqësuesit të OE ankues z. Bytyqi i cili deklaroi: Ne si OE pjesëmarrës në këtë aktivitet për herë të dytë kemi parashtruar sipas ligjit fillimisht kërkesë për rishqyrtim në AK dhe pasi na është refuzuar kërkesa kemi ushtruar ankesë në OSHP. Për të mbështetur pretendimet tona si OE pjesëmarrës kemi ofrua fakte dhe argumente të qëndrueshme lidhur me mos respektimin themelor të vendimit të OSHP-së nr. 368/17 nga ana e AK-së dhe njëjtën kohë mos respektimin e specifikimeve teknike të detyrueshme dhe nënkritereve teknike për vlerësimin që ka qenë pjesë e dosjes nga ana e AK-së gjatë

procedurës së rivlerësimit. Siç e thash AK duke na poentuar neve në gjitha nënkrutitet me zero pikë, pa u bazuar në vlerësimin konkret në bazë të nënkrutiteve teknike dhe specifikeve teknike të detyrueshme ku shihet qartë se kriteri bazik i këtyre specifikeve përveçkrutiteve tjera është edhe përmbajtja e projektit aplikues. Do thotë AK nuk e ka bërë vlerësimin në këto parime që përmenda. Në mënyrë specifike AK nuk ka respektua vendimin e OSHP ku është konstatuar se projektin është kompletuar në aspektin e programit projektues, pastaj konstatimi se projekti ka kualitet hapësinorë, është projekt i bazuar në programin e dhënë nga AK dhe se ka ofruar qasje ekonomike. Po ashtu i rikujtojmë se vendimi i OSHP ka konstatuar se AK në dosjen e konkursit të projektimit nuk ka caktua prag numerik për nivelin e pranueshmërisë prandaj ashtu siç ceket bën vendim është i paqëndrueshëm konstatimi se projekti 1140 nuk është në nivelin e pranueshëm. Konstatimi i fundit i vendimit të OSHP është që mangësitë eventuale të projektit ideor mund të plotësohen në fazën e projektit kryesor. Ne kur kemi marr raportin e tretë të rivlerësimit nga KK Prishtinë, kemi pa që ky raport nuk është i bazuar në këto pika që ceka më herët, nuk është i bazuar në kërkesa të specifikeve teknike të detyrueshme, dhe as në nënkriter teknike të vlerësimit për arsye se tek tabela nënkrutitëve teknike nuk është dhënë asnjë sqarim bazuar në këto specifike teknike të detyrueshme për poentimin me zero pikë të secilit nënkriter. Edhe pse ky është një projekt ideor juri në konstatime të saj në fund të raportit të rivlerësimit merret me mënyrë e prezantimit grafik të vijave, me gjera tjera teknike i mungesa një lavamani, me formën arkitektonike të erëmbrojtësit, me paraqitjen teknike të detajeve në prerje dhe fasada të një projekti ideor, dhe në disa raste bënë edhe bërjtje tjera të bazuara në konstatime subjektive të cilat përsërisin se nuk janë kërkesa të specifikeve teknike të detyrueshme të kësaj dosje të konkursit të projektimit. Bazuar në gjitha konstatime na poentojnë me zero pikë. Në anën tjetër duhet potencuar se është skandaloze që juri profesionale me asnjë shkronjë nuk merret me respektimin nga ana e projektit tonë të specifikeve teknike të detyrueshme të dosjes dhe me kualitetet teknike, hapësinore, arkitektonike, estetike, programore, ekonomike, ekologjike të projektit tonë, që janë konstatuar edhe nga vendimi i OSHP e që e ka pas obligim të respektoj, pro kjo juri në mënyrë tendencioze synon të rrënoj gjithçka në projekt me qëllimin e vetëm që këtë projekt ta eliminoj sërish me çdo kusht nga mundësia shpalljes fitues të këtij konkursi, qoftë duke dhënë edhe një pikë të vetme të cilën mund ta vlerësonte këtë projekt. Në ankesën tonë kemi potencuar edhe mos respektimin e dispozitave të LPP dhe UOPP-së, nga ana e AK-së, pra mos respektimi i nenit 80.2 të LPP ku thuhet Juri do vendos mbi konkursin vetëm në bazë të kriterëve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit, pastaj neni 57 të UOPP-së i cili është i njëjtë që thotë juri do vlerësoj projektet vetëm në bazë të kriterëve të shënuara në dosjen e konkursit, pastaj mos respektimi i nenit 41 të UOPP pika 41.3, ku thuhet tenderët udhë të jenë të pranishëm dhe duhet të përmbushin kërkesën minimale të kualifikimit, nëse janë përcaktuar në dosje, ndërsa në këtë dosje ato janë përcaktuar dhe ne i kemi respektuar. Neni i fundit 41.11 të UOPP-së ku thuhet se tenderuesi nuk do diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo

kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin për kontratë apo dosje të tenderit. Un jam i kënaqur që edhe raporti i ekspertit edhe në këtë rast si herën e parë konstaton shkeljet e dispozitave ligjore nga ana e AK-së dhe gjatë procesit të rivlerësimit dhe duke pas parasysh këto shkelje të dispozitave ligjore kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-së që bazuar në kompetencat sipas neni 105 të LPP pas seancës me urdhëresë ta detyroj ligjërisht AK-në të respektoj vendimin e OSHP nr.368/17 të datës 08.11.2017 duke kthyer përsëri në rivlerësim këtë konkurs dhe duke detyruar ligjërisht AK të poentoj në mënyrë meritore të ligjshme dhe të pavarur projektin 1140 në bazë të kritereve teknike të dosjes së konkursit të projektimit.

Gjatë prezantimit në seancë fjala ju dha përfaqësuesit të AK-KK Prishtinë znj.Emrullahu e cila deklaroi: Pas pranimit të vendimit të OSHP, Ne jemi thirrur si juri profesionale të analizojmë në aspektin urbanistik , funksional , estetik , projektin ideor për qendrën për autorzëm dhe sindrom donë. Në fillim duke filluar nga zgjidhja urbanistike, janë kërkuar 1:1000, 1:500, dhe 1:200. Në to është këraur raporti i objektit në harmoni me zonën të cilën do të trajtohet. Dhe është vërejtur që nuk është e qartë ndarja e komunikacionit automobilistik nga aj i këmbësoreve. Duhet të cek në këtë tri përpjesë, niveli i detajzimit duhet të jetë i ndyshëm, ndërsa në projektin e OE ankues është niveli detajzimit është i njëjtë. Siguria nga zjarri, ndërmjet dy ndërtesave fqinjë kërkon që distanca minimale ndërmjet ndërtesave të jetë së paku $\frac{1}{2} H$ e ndërtesës më të lart. Kjo distancë minimale zbatohet për gjitha llojet e ndërtesave në gjitha zonat specifike. Në situacione mbrapa që shpie në garazhë është në shpërpushje me situacionin dhe planimetrinë e përdhese. Pjerrtësia e rampës në projekt është e paraqitur me 14%, ndërsa në llogaritje është më e madhe se 14%. Rampa që shpie në garazhë e pengon fusha e sportit të gjendet mbi garazhë, dhe realisht nuk mund të futet vetura në garazhë. Rampa me këtë prezantim të OE realisht është jo funksionale. I ofrojmë panelit shqyrtues një kopje të shkresës-kundërshtimit tonë në raportin ekspertizës me arsyetimet e AK-së për vlerësimin. Ne si komision vlerësues profesional kemi dhënë vlerësimin tonë duke u bazuar në letër, në dokumentet e ofruara nga OE-të.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit teknik znj.Alloqi, e cila deklaroi: Kjo është lëndë të cilën e shqyrtoj për herë të dytë, dhe është lëndë bukur e ndjeshme. Gjitha pikat e OE ankues qëndrojnë, sepse AK kur ka shpall konkursin e prodhimit nuk ka cek pragun e kalueshmërisë, për këtë arsye AK gjitha pikat e nënkritereve i ka vlerësuar me zero. Më vjen mirë që sot përfaqësues të AK janë arkitekt, pasi vërejtjet e AK kanë qenë vërejtje teknike , mirëpo jo vërejtje përmabjtësore që mund të eliminojnë projektin OE , pasi projekti 1140 ka qenë teknikisht i në rregull. Përdërisa një projekt është teknikisht në rregull atëherë komisioni është dashtë të bëjë vlerësimin sipas kritereve dhe nënkritereve që kanë dhënë në konkursin e projektimit. Si shembull një prej vërejtjeve ka qenë mbrojtësi, dhe këtë OE e ka dhënë, mirëpo forma, dizajni, ngjyra nuk ka qenë e caktuar me kritere, dhe nuk mund të vlerësohet nga komisioni me zero pikë, me që është dhënë mbrojtësi si

element atëherë AK mundet ta vlerësoj nga 1 deri 100. Ose prerjet karakteristike të objektit, kujtoj edhe njëherë se në fazën e projekt ideor mjafton për te përcaktohet lartësia e Etazheve. Është dhënë si vërejtje se nuk janë përcaktuar shtresat. Në projektin e OE janë detajet ku janë që paraqitur edhe shtresat konsultive komplet, edhe pse te projektet ideore prerjet nuk mund të kompletohen asnjëherë, ato plotësohen në fazën e projektit kryesor. Vlerësimi me zero pikë në këtë rast është i pakuptimtë. Edhe pse projekti i OE nuk është më i miri, prapë i njëjti nuk mund të poentohet me zero pikë, pasi ka material të bollshëm për tu dhënë të paktën një pikë, andaj për këtë mendoj se duhet kthyer projekti në rivlerësim.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: Me qëllim që të mos bëhen shkelje të reja, kam informacione se KK Prishtinë ka realizuar një vizitë në Turqi dhe në atë vizitë është thënë se ka marr mbështetje në ndërtim përmes agjencisë TIKA për ndërtimin e këtij projekti. Vetëm disa ditë pas atij informacioni nga disa kolegë në instagram kam par një fotografi që është ëpostuar nga kryetarja e jurisë së mëhershme znj. Mimoza Sylejmani, ku thuhet decidivisht “këta katër arkitek do ta projektojnë këtë projekt” dhe aty shihen personat konkret. Nëse pranohet ky donacion, inicimi i këtij aktiviteti është bërë me deklaratë për disponueshmëri të mjeteve dhe të mos lejohet AK që të anulohet aktivitetin me arsyetim të mungesës së mjeteve. I propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj ankesën tonë dhe lëndën siç potencova më lart ta kthej në rivlerësim.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK znj. Emrullahu deklaroj: I propozojmë panelit shqyrtues të refuzoj ankesën e OE ankues dhe të vërtetoj vendimin e AK-së për anulim si të bazuar.

Në fund ekspertit shqyrtues znj. Alloqi deklaroj: Qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve dhe rekomandime të dhëna në raport.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se është i qëndrueshëm pretendimi ankimor i OE ankues për mos respektim të nenit 59 të LPP-së për faktin se autoriteti kontraktues pas hapjes së ofertave duhet të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe nëse nuk ka ofertues që i kanë plotësuar kërkesat e FDT-se mund të vijë deri tek anulimi i aktivitetit të prokurimit.

Paneli shqyrtues sa i përket pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues ku thuhet: AK-ja gjatë Ri-vlerësimit pas shpalljes së vendimit të OSHP-së shihet qartë se ka përsëritur shkelje ligjore të cilat i ka bërë dy herë radhazi kur ka marrë vendim për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, duke e shpallur fillimisht projektin 1140 të dobët, dhe pastaj në nivel të papranueshëm duke e poentuar në të gjitha nënkriteret me zero pikë pa i vlerësuar bazuar në këto nënkritere projektin 1140, edhe pse vetë AK në të dy rastet të njëjtin projekt e vlerëson se është në përputhje për Specifikimet Teknike Të Detyrueshme, përkatësisht me përmbajtjen e projektit aplikues (që në dosjen e tenderit është kriteri minimal dhe bazik teknik i Specifikuar për pranueshmërin e projekteve aplikuese). AK-ja gjatë procesit të rivlerësimit nuk i ka marrë fare për bazë obligimet që dalin nga vendimi i OSHP-së, ku është konstatuar ligjërisht se projekti 1140 është i kompletuar në aspektin fizik të programit projektues; dhe mbi të gjitha se projekti 1140 ka kualitet hapsinor, është projekti i bazuar në programin e dhënë nga AK-ja dhe ka ofruar qasje ekonomike; pastaj konstatimin se AK-ja, në Dosjen e Konkursit të Projektimit nuk ka caktuar prag numerik për nivelin e pranueshmëris prandaj është i paqëndrueshëm konstatimi se projekti 1140 nuk është në nivelin e pranueshëm, si dhe nuk e ka marrë fare për bazë konstatimin se mangësit eventuale të projektit ideor 1140 mund të plotësohen në fazën e projektit kryesor. Lidhur me pretendimet e cekur si me lart paneli shqyrtues konstaton se komisioni pas Ri-vlerësimit të projektit ka rekomandon anulimin e konkursit të projektimit për mungesë të projekteve të pranueshme”. Ky konstatim i jurisë profesionale është i pa qëndrueshëm pasi që AK-ja nuk ka caktuar prag të kalueshmërisë. Si i tillë pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues është i qëndrueshëm.

Paneli shqyrtues konstatonte Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet: “Shpjegimet” e AK-se në bazë të cilave ne jemi eliminuar sërish nga ky autoritet kontraktues nuk janë të bazuara as në Aneksin 1. Specifikimet Teknike dhe/ose estetike të Detyrueshme të dosjes së Konkursit për projektim dhe në as në Nënkriteret Teknike të vlerësimit të prezantuara në FDT dhe në kuadër të këtyre specifikimeve teknike. “Shpjegimet” apo vërejtjet e juris profesionale të dhëna në letrën standarde të eliminimit dhe në raportin e Ri-vlerësimit, nuk janë të mbështetura saktësisht me kërkesat e Specifikimeve Teknike të Dosjes së Konkursit të Projektimit e as me nënkriteret teknike, për arsye se tek tabela e nënkritereve teknike nuk është dhënë asnjë sqarim bazuar në këto Specifikime Teknike të Detyrueshme për poentimin me Zero pikë të secilit nënkriter. Paneli shqyrtues konstaton se pretendimet e cekura si me lart janë të qëndrueshme për faktin se projekti 1140 është i kompletuar në aspektin fizik të programit projektues duke plotësuar të dhjetë pikat përmbajtësore të kërkuara në dosjen e konkursit të projektit. Vërejtjet e cekura nga komisioni vlerësues qëndrojnë që të gjitha, por janë vërejtje më shumë teknike dhe jo përmbajtësore. P.sh. vërejtja e ermbërojtësit, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme prezantimi i mbrojtësit ka qenë detyrim, por forma e tij nuk është përcaktuar, si e tillë vërejtja është teknike sepse mundë të ndryshohet gjatë projektit kryesor por asesi nuk është vërejtje

përmbajtjesore e cila do ta diskualifikonëtë projektin në fjalë. Ose tekë vërejtjet e prezantimit të prerjeve se nuk janë të përfunduara ose nuk kanë të paraqitur shtresat. Kujtojmë që kemi të bëjmë me fazën e projektit ideor në të cilën fazë mjafton të prezentohen kotat e lartësisë dhe gjithçka tjetër detajizohet paralel me fazën e strukturës dhe fazave tjera.

Paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues ku thuhet: Neni 80, pika 2 e Ligjit të Prokurimit Publik sqaron saktësisht se “Jurija do të vendos mbi konkursin vetëm në bazë të kriterëve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit”, është i qëndrueshëm pretendimi i Operatorit Ekonomik pasi që vërejtjet e cekura në raportin e Ri-vlerësimit janë vërejtje teknike e jo përmbajtjesore e për më shumë nuk janë të cekura në Specifikat Teknike të Detyrueshme të dosjes së projektimit.

Paneli shqyrtues konstaton se neni 57, pika 5.7.26 e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, sqaron se: “Jurija do të vlerësojë projektet vetëm në bazë të kriterëve të shënuara (pikët e peshës të shënuara në Dosjen e Konkursit të Projektimit)”. Andaj paneli shqyrtues konsideron se juria profesionale ka bërë vlerësimin duke u bazuar më shumë në çështje teknike apo prezantim të projektit, por jo duke u thirrur konkretisht në kriteret apo nënkriteret e paraqitura në dosjen e konkursit të projektimit, mbi të cilat është dashtë të behët vlerësimi. P.sh nuk ka dhënë pikë (ku vlerësimi ka mundë të jetë 1 deri në 100 pikë) tek Kriteri Estetik dhe Ekologjik apo tek Nënkriteri Respektimi dhe Përmbyllja e Detyrës Projektuese dhe Programit Hapsinor. Nisur nga fakti që projekti 1140 ka qenë i kompletuar në aspektin përmbajtësor atëherë për çdo kriter dhe nënkriter ka pas material për vlerësim, ndërkohë që vlerësimi me 0 pikë është i pakuptim.

Paneli shqyrtues sa i përket pretendimit të OE ankues se neni 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, pika 41.3 (Parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP-së), i po këtij Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik sqaron po ashtu se: “Tenderët duhet të jenë të pranueshëm dhe duhet të përmbushin kërkesat minimale të kualifikimit (nëse janë përcaktuar). Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara. Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kriterëve të specifikuara të dhënies së kontratës. Vetëm kërkesat dhe kriteret e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosjen e tenderit mund të përdoren si bazë për vlerësim”. Paneli shqyrtues pas sqarimeve dhe konstatimeve të dhëna edhe nga eksperti profesional konstaton se qëndron pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues pasi që projekti 1140 ka përmbushur kërkesat minimale të kualifikimit të cilat janë specifikuar në Dosjen e Konkursit të Projektimit-që janë: Përmbajtja e Projektit aplikues.

Paneli shqyrtues sa i përket pretendimit të ankuesit se neni 41, pika 41.11 e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik e definon edhe më qartë se: “Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës/dosjen të tenderit”. Paneli konstaton se vërejtjet e bëra nga juriya profesionale nuk janë të bazuara në kriteret apo nënkriteret teknike e as në Specifikimet Teknike të Detyrueshme të dosjes së konkursit të projektimit. Si i tillë pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues është i qëndrueshëm.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK -“Komuna e Prishtinës

1x1 OE -NTP Prima Engineering sh.p.k. – Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.